LIGJI NR. 08/L-264

PËR RININË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR RININË

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim rregullimin e fushës së rinisë në nivel ndërinstitucional dhe ndër sektorial, duke e vendosur rininë në qendër të prioriteteve shtetërore, me synim avancimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe të barabartë në procesin e vendimmarrjes si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre shoqëror.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik si dhe institucionet e tjera në Republikën e Kosovës që kanë të drejta, përgjegjësi dhe autorizime të caktuara në fushën e rinisë.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. Moshë rinore ose “i ri/e re” - grupmosha e të rinjve prej pesëmbëdhjetë (15) deri në njëzet e nëntë (29) vjeç;

1.2. Komisioni - Komisioni Shtetëror për Rini;

1.3. Ministria - ministria përkatëse për rini;

1.4. Agjencia - Agjencia për Zhvillimin e Rinisë;

1.5. Institucionet publike qendrore - ministritë, agjencitë dhe administrata e shërbimeve publike;

1.6. Institucionet publike lokale - komunat, duke përfshirë drejtoritë përkatëse për rini;

1.7. Këshilli Qendror - Këshilli Qendror Rinor;

1.8. Këshilli Lokal - Këshilli Lokal Rinor;

1.9. Hapësira rinore - hapësirë shumëfunksionale në shërbim të nevojave të rinisë ku ata ushtrojnë veprimtari dhe që plotëson standardet e sigurisë, funksionimit dhe gjithëpërfshirjes;

1.10. Politika rinore - politika të zbatuara nga institucionet publike me qëllim të ofrimit të mundësive dhe përvojave për të rinjtë që mbështesin integrimin e suksesshëm në shoqëri, pjesëmarrjen aktive në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe mbështetjen për t'u bërë faktorë të ndryshimit;

1.11. Sektori i rinisë - të gjitha organizatat qeveritare, joqeveritare, grupet joformale dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë të angazhuar në zbatimin e politikave dhe programeve rinore;

1.12. Program rinor - program në kuadër të sektorit të rinisë, në kohëzgjatje më shumë se gjashtë (6) muaj, që adreson nevojat e të rinjve dhe promovon zhvillimin e rinisë;

1.13. Organizatë rinore - organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, në të cilën së paku dy të tretat (⅔) e anëtarëve janë të moshës rinore;

1.14. Organizatë për të rinjtë - organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që në fushëveprimin dhe statutin e saj ka referencë sektorin e rinisë dhe u shërben të rinjve;

1.15. Grup joformal rinor - grup i të rinjve, të cilët janë bashkuar rreth qëllimeve të përbashkëta shoqërore, i cili nuk posedon ndonjë status juridik sipas legjislacionit në fuqi dhe përfaqësohet nga anëtarët e grupit;

1.16. Vullnetarizmi rinor- ofrimi i kohës, i punës dhe i njohurive të të rinjve gjatë kohës së lirë, pa pagesë, për përfitimin e njohurive dhe përvojave dhe për zhvillimin personal dhe profesional si dhe për t'i shërbyer komunitetit;

1.17. Edukim joformal - programe të strukturuara për të zhvilluar shkathtësitë e të rinjve, të cilat mund të interpretohen si kombinim i njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave, qasjeve dhe përvojave, jashtë kurrikulës formale arsimore zakonisht të zbatuara në hapësira rinore;

1.18. Pjesëmarrja e të rinjve - proces që siguron përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje publike në lidhje me programet dhe politikat, përfshirjen aktive në zbatimin e aktiviteteve dhe nismave që kontribuojnë për shoqërinë në tërësi dhe në të gjitha nivelet;

1.19. Puna rinore - aktivitetet që realizohen me dhe për të rinjtë me qëllim të zhvillimit personal dhe social, në përputhje me nevojat dhe mundësitë e tyre duke u bazuar në metodat e edukimit joformal;

1.20. Punëtor rinor - profesionist që zotëron kompetencat dhe përvojën e nevojshme për të punuar me dhe për të rinjtë për të zbatuar aktivitete të punës rinore;

1.21. Dialog i strukturuar - dialogu transparent, i vazhdueshëm dhe sistematik ndërmjet institucioneve publike qendrore dhe lokale, të rinjve, organizatave dhe hisedarëve të tjerë të sektorit të rinisë në lidhje me çështjet e rinisë.

Neni 4
Parimet e zbatimit të ligjit

1. Ky ligj bazohet në parimet siç janë:

1.1. barazia, mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi;

1.2. pavarësia, pluralizmi dhe demokracia në të gjitha format e organizimit të të rinjve;

1.3. transparenca dhe llogaridhënia;

1.4. përfaqësimi gjithëpërfshirës dhe demokratik i bazuar në merita në çdo mekanizëm rinor;

1.5. qasja për zhvillim pozitiv;

1.6. pjesëmarrja kuptimplote e të rinjve në identifikimin dhe trajtimin e nevojave në fushën e rinisë;

1.7. bashkëpunimi ndërinstitucional në hartimin dhe zbatimin e politikave rinore;

1.8.multikulturalizmi dhe ndërkulturalizmi në pjesëmarrjen aktive të të rinjve;

1.9. përgjegjësia dhe solidariteti ndërmjet të rinjve si dhe mes gjeneratave.

2. Të gjitha format e organizimit të të rinjve, institucionet publike qendrore dhe lokale dhe të rinjtë duhet të respektojnë parimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni në punën e tyre dhe në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me rininë.

Neni 5
Të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve për vetorganizim

1. Çdo i ri ka të drejtë të zhvillohet, pa u përballur me diskriminim dhe duke u bazuar në mundësi të barabarta. Në realizimin e të drejtave nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje nga institucionet publike qendrore dhe lokale, përveç rastit kur një gjë e tillë parashihet me ligj dhe sigurohet largimi i të gjitha pengesave për realizimin e të drejtave.

2. Të rinjtë kanë të drejtë të vetorganizohen me vullnetin e tyre të lirë në organizata dhe grupe të tjera formale dhe joformale dhe në të gjitha format e organizimit shoqëror, duke përfshirë të drejtën e votimit dhe zgjedhjes në trupa të ndryshëm të përfaqësimit rinor.

3. Të rinjtë kanë të drejtë të marrin informacione për çështjet me interes për ta, duke përfshirë strategjitë dhe buxhetet në fushën e rinisë, politikat rinore, programet rinore dhe dokumentet e tjera ligjore me interes për të rinjtë.

4. Të rinjtë kanë përgjegjësi të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të ndjekin edukimin obligativ, të veprojnë duke respektuar vlerat e paqes, tolerancës dhe komunikimit jodiskriminues dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë demokratike.

5. Organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, si dhe grupet joformale rinore që përfaqësojnë interesat e të rinjve, mund të bashkëpunojnë me organizata simotra të shteteve të tjera duke siguruar përfaqësimin e rinisë ndërkombëtarisht.

6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve të grupmoshës pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç rregullohen me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijës.

KAPITULLI II
ORGANIZIMI I MEKANIZMAVE INSTITUCIONAL

Neni 6
Komisioni Shtetëror për Rini

1. Komisioni Shtetëror për Rini është mekanizmi më i lartë bashkërendues ndërinstitucional për zbatimin e politikave rinore sektoriale dhe ndërsektoriale.

2. Komisioni themelohet me vendim të Qeverisë, udhëhiqet nga kryeministri/ja dhe përbëhet nga ministritë në nivel të ministrave.

3. Përfaqësuesi i Këshillit Qendror Rinor merr pjesë në takimet e Komisionit me rol këshillues, avokues dhe monitorues.

4. Komisioni mban takime së paku dy (2) herë në vit dhe përgjegjësitë e tij janë si në vijim:

4.1. përcaktimi i prioriteteve dhe i masave të nevojshme që duhet të ndërmerren për adresimin e nevojave të të rinjve në harmonizim me dokumentet strategjike si programi i qeverisë, planet e punës së ministrive dhe strategjitë e tjera që prekin fushën e rinisë;

4.2. propozimi i themelimit të grupeve punuese ndërsektoriale të ndryshme për trajtimin e çështjeve dhe ofrimin e zgjidhjeve në sektorin e rinisë;

4.3. bashkërendimi i institucioneve dhe mekanizmave që kanë ndikim në sektorin e rinisë;

4.4. raportimi mbi zbatimin e politikave rinore, përfshirë Strategjinë Shtetërore për Rini, dhe miratimi i raportit vjetor të Strategjisë.

5. Obligohen të gjitha institucionet qendrore dhe lokale që të bashkëpunojnë dhe të zbatojnë vendimet e Komisionit.

Neni 7
Institucionet publike qendrore

1. Institucionet publike qendrore të cilat mbulojnë fushat me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e rinisë promovojnë një qasje ndërsektoriale për rininë.

2. Fushat me ndikim, por që nuk kufizohen, janë në:

2.1. kulturë dhe sport;

2.2. punë dhe mirëqenie;

2.3. shëndetësi;

2.4. siguri;

2.5. arsim, inovacion dhe edukim joformal;

2.6. ekonomi dhe ndërmarrësi;

2.7. diasporë;

2.8. qeverisje lokale;

2.9. barazi gjinore;

2.10. mbrojtje të mjedisit;

2.11. të drejtat e njeriut dhe komuniteteve.

3. Përgjegjësitë e institucioneve publike qendrore janë si në vijim:

3.1. hartimi, miratimi dhe zbatimi i dokumenteve strategjike, politikave sektoriale rinore, akteve ligjore dhe nënligjore të fushës së tyre që kontribuojnë në zhvillimin e rinisë;

3.2. ndarja e fondeve të nevojshme në planet vjetore dhe shumëvjeçare buxhetore për zbatimin e politikave rinore;

3.3. bashkëpunimi ndërinstitucional për hartimin dhe zbatimin e politikave ndërsektoriale;

3.4. sigurimi i procedurave që garantojnë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të të rinjve në vendimmarrje në fushat e tyre përkatëse duke e përfshirë Këshillin Qendror;

3.5. mbledhja dhe ofrimi i të dhënave për të rinjtë në fushat e tyre përkatëse, të cilat janë të qasshme dhe publike.

4. Institucionet publike qendrore përmbushin përgjegjësitë ndaj rinisë në bashkërendim me Ministrinë.

Neni 8
Ministria përkatëse për rini

1. Ministria përkatëse për rini është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit, politikave në fushën e rinisë dhe ofrimin e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve të të rinjve në fushat kulturore, rinore, rekreative dhe sportive në koordinim me Agjencinë, institucionet publike qendrore dhe lokale dhe Këshillin Qendror.

2. Funksionet dhe përgjegjësitë e Ministrisë në fushën e rinisë janë:

2.1. hartimi dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e rinisë dhe propozimi i ndryshim/plotësimeve të ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë ndikim në rininë;

2.2. hartimi i politikave rinore, duke përfshirë Strategjinë Shtetërore për Rini;

2.3. monitorimi i zbatimit të Strategjisë Shtetërore për Rini dhe përgatitja e raporteve periodike për Komisionin;

2.4. administrimi i investimeve kapitale në fushën e rinisë përfshirë hapësirat rinore;

2.5. mbështetja e përgjithshme e menaxhimit, menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore, auditimit të brendshëm dhe monitorimit të Agjencisë.

Neni 9
Agjencia për Zhvillimin e Rinisë

1. Agjencia për Zhvillimin e Rinisë është agjenci ekzekutive e cila vepron në kuadër të Ministrisë.

2. Agjencia është institucion i administratës shtetërore që zbaton dhe bashkërendon veprimtarinë në fushën e rinisë.

3. Agjencia është e pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Neni 10
Organizimi i Agjencisë

1. Agjencia kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me këtë ligj.

2. Agjencia udhëhiqet nga drejtori/esha ekzekutiv/e, i/e cili/a është përgjegjës/e për administrimin, funksionimin, përfaqësimin dhe menaxhimin e Agjencisë.

3. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës ekzekutiv/e rregullohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Struktura dhe organizimi i Agjencisë rregullohen me akt nënligjor në përputhje me ligjin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Neni 11
Funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë

1. Përgjegjësitë e Agjencisë janë si në vijim:

1.1. zbatimi i politikave rinore, duke u bazuar në Strategjinë Shtetërore për Rini;

1.2. mbështetja e themelimit dhe funksionimit të Këshillit Qendror, në aspektin financiar dhe administrativ, dhe bashkëveprimi për identifikimin e nevojave të rinisë;

1.3. bashkëpunimi me institucionet publike qendrore dhe lokale dhe mbështetja për sigurimin e zbatimit të dispozitave të legjislacionit në fushën e rinisë;

1.4. mbështetja e Komisionit për koordinimin, monitorimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të nevojshme për punën e Komisionit;

1.5. mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve për pjesëmarrje në mekanizmat rinorë dhe vendimmarrje publike në të gjitha nivelet;

1.6. bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe ofrimi i mbështetjes financiare për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë për zhvillimin e rinisë;

1.7. bashkëpunimi me sektorin privat për punësimin dhe ofrimin e edukimit joformal për të rinjtë dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërmarrëse rinore;

1.8. mbështetja, ngritja e kapaciteteve dhe financimi i qëndrueshëm i vullnetarizmit rinor, punës rinore dhe edukimit joformal;

1.9. ofrimi i certifikimeve për vullnetarizmin rinor dhe i licencimeve për punëtorët rinorë në fushën e rinisë;

1.10. mbështetja programatike dhe financiare e mobilitetit rinor brenda dhe jashtë vendit;

1.11.mbledhja e të dhënave në fushën e rinisë nga institucionet publike qendrore dhe lokale dhe menaxhimi i bazës së të dhënave të fushës së rinisë, e cila është e qasshme dhe publike.

2. Në ushtrimin e përgjegjësive të saj Agjencia bashkëpunon me institucionet publike qendrore dhe lokale, Këshillin Qendror, Këshillat Lokalë, organizatat rinore dhe organizatat për të rinj.

Neni 12
Institucionet publike lokale

1. Përgjegjësitë e institucioneve publike lokale, përfshirë drejtorive komunale të rinisë, janë:

1.1. hartimi dhe zbatimi i politikave lokale në fushën e rinisë dhe plani vjetor për rini të cilat janë në përputhje me Strategjinë Shtetërore për Rini dhe në koordinim me Këshillat Lokalë;

1.2. sigurimi i resurseve njerëzore në komunat përkatëse, përfshirë caktimin e së paku një zyrtari/eje rinor/e, me kapacitete profesionale për: identifikimin, koordinimin, bashkëpunimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave rinore në komunat përkatëse;

1.3. mbështetja financiare për sektorin e rinisë, programet rinore dhe qendrat rinore;

1.4. dhënia e lejes për organizatat rinore dhe/ose organizatat për të rinjtë për menaxhimin e qendrave rinore dhe monitorimi i veprimtarisë së tyre në bashkëpunim me Agjencinë dhe Këshillin Lokal;

1.5. mbledhja e të dhënave në fushën e rinisë në komunat e tyre përkatëse, të cilat janë të qasshme dhe publike.

2. Komunat monitorohen përmes sistemit të menaxhimit të performancës, përmes indikatorëve nga ministria përgjegjëse për qeverisje lokale për zbatimin e planit vjetor për rini dhe të legjislacionit në fuqi në fushën e rinisë.

KAPITULLI III
FUQIZIMI I PJESËMARRJES SË TË RINJVE

Neni 13
Pjesëmarrja e të rinjve

1. Pjesëmarrja gjithëpërfshirëse e të rinjve duhet sigurohet përmes:

1.1. pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje dhe hartimin e politikave dhe programeve në nivel qendror dhe lokal përmes konsultimeve të hapura për publikun, anëtarësimin në Këshillin Qendror dhe Këshillat Lokalë, organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe grupet joformale;

1.2. pjesëmarrjes aktive në çdo nivel dhe fushë shoqërore që është me interes për fushën e rinisë dhe që synon përmirësimin e jetës së të rinjve;

1.3. pjesëmarrjes digjitale për çështjet me interes në fushën e rinisë, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë.

Neni 14
Këshilli Qendror Rinor

1. Këshilli Qendror Rinor është grup këshillues, avokues dhe monitorues për çështjet rinore, i cili shërben si platformë për bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë, Këshillave Lokalë, organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe grupeve joformale.

2. Këshilli Qendror ka përgjegjësi të identifikojë nevojat e të rinjve dhe të propozojë hartimin e politikave dhe programeve për përmirësimin e sektorit të rinisë.

3. Agjencia funksionon si sekretariat i Këshillit Qendror dhe ka për detyrë mbështetjen e procesit të themelimit të Këshillit Qendror dhe të zhvillimit të aktiviteteve të tij.

4. Këshilli Qendror themelohet përmes asamblesë së përgjithshme të anëtarëve në një proces demokratik dhe transparent.

5. Anëtarët e asamblesë së Këshillit Qendror nominojnë dhe përzgjedhin anëtarët e organeve/strukturave udhëheqëse të Këshillit Qendror përmes votimit. Këshilli Qendror duhet të sigurojë përfaqësim të gjerë dhe gjithëpërfshirës, duke pasur parasysh aspektin gjinor dhe të rinjtë nga komunitetet joshumicë, zonat rurale, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të margjinalizuara.

6. Agjencia dërgon njoftimin për përbërjen e Këshillit Qendror të ministri/ja. Këshilli Qendror njihet nga ministri/ja me mandat tre (3) vjeçar.

7. Agjencia ka për detyrë të mbulojë kostot financiare të Këshillit Qendror. Këshilli gjithashtu mund të pranojë mbështetje financiare nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë.

8. Mbështetjet financiare të pranuara nga Këshilli Qendror nuk duhet të ndikojnë në vendimet dhe aktivitetet e Këshillit Qendror.

9. Procedurat e themelimit, organizimit dhe funksionimit të Këshillit Qendror Rinor rregullohen me akt nënligjor nga ministria përkatëse për rini dhe aktet normative të Këshillit.

Neni 15
Këshillat Lokal Rinor

1. Këshillat Lokal Rinor janë grupe këshilluese, avokuese dhe monitoruese për çështjet rinore, të cilat shërbejnë si platformë për bashkëpunim mes institucioneve publike lokale, Këshillit Qendror, organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe grupeve joformale në komunat përkatëse.

2. Këshillat Lokalë kanë përgjegjësi të identifikojnë nevojat e të rinjve në komunat përkatëse dhe të mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e hartimit dhe vlerësimit të politikave rinore në nivel lokal.

3. Drejtoria komunale e rinisë funksionon si sekretariat i Këshillit Lokal dhe ka për detyrë mbështetjen e procesit të themelimit të Këshillit Lokal dhe të zhvillimit të aktiviteteve të tij.

4. Këshillat Lokalë themelohen përmes asamblesë së përgjithshme të anëtarëve në një proces demokratik dhe transparent.

5. Anëtarët e asamblesë së Këshillit Lokal nominojnë dhe përzgjedhin anëtarët e organeve/strukturave udhëheqëse të Këshillit Lokal përmes votimit. Këshilli Lokal duhet të sigurojë përfaqësim të gjerë dhe gjithëpërfshirës, duke pasur parasysh aspektin gjinor dhe të rinjtë nga komunitetet joshumicë, zonat rurale, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të margjinalizuara.

6. Drejtoria komunale e rinisë dërgon njoftimin për përbërjen e Këshillit Lokal te kryetari/ja i/e komunës. Këshilli Lokal njihet nga kryetari/ja i/e komunës përkatëse me mandat tre (3) vjeçar.

7. Drejtoria komunale e rinisë ka për detyrë të mbulojë kostot financiare të Këshillit Lokal. Këshilli gjithashtu mund të pranojë mbështetje financiare nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë.

8. Mbështetjet financiare të pranuara nga Këshillat Lokalë nuk duhet të ndikojnë në vendimet dhe aktivitetet e Këshillave Lokalë.

9. Procedurat e themelimit, organizimit dhe funksionimit të Këshillave Lokal rregullohen me akt nënligjor nga ministria përkatëse për rini dhe aktet normative të Këshillit.

Neni 16
Qendrat rinore

1. Qendrat rinore janë hapësira rinore të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, të cilat përdoren nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, grupet joformale dhe komuna për zbatimin e aktiviteteve në fushën e rinisë dhe punën rinore.

2. Drejtoria komunale e rinisë në bashkëpunim me Këshillin Lokal dhe me Agjencinë përbëjnë komisionin vlerësues për përzgjedhjen e organizatës rinore apo organizatës për të rinjtë për dhënien e lejes për menaxhimin e qendrës rinore përmes thirrjes publike.

3. Secila komunë do të pajisë me leje dhe do të mbështesë të paktën një qendër rinore por mund të pajisë me leje edhe qendra të tjera rinore në bazë të kërkesave dhe mundësive.

4. Dy apo më shumë komuna mund të hyjnë në bashkëpunim ndër komunal për mbështetjen e një qendre rinore e cila i shërben të rinjëve të atyre komunave.

5. Drejtoria komunale e rinisë lëshon lejen me kohëzgjatje tre (3) vjeçare.

6. Organizatat e pajisura me leje për menaxhimin e qendrave rinore sigurojnë mbështetje financiare për zbatimin e planit vjetor të aktiviteteve nga komuna. Institucionet publike qendrore dhe donatorët e jashtëm mund të ofrojnë mbështetje financiare shtesë.

7. Procedurat e dhënies së lejes, funksionimit dhe menaxhimit të qendrës rinore rregullohen me akt nënligjor nga ministria përkatëse për rini.

KAPITULLI IV
POLITIKAT RINORE

Neni 17
Strategjia Shtetërore për Rini

1. Strategjia Shtetërore për Rini është dokument ndër sektorial që përcakton qëllimet dhe prioritetet afatmesme të qeverisë si dhe masat për përmbushjen e tyre.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të ministrisë përkatëse për rini miraton Strategjinë Shtetërore për Rini.

3. Ministria përgatit raport vjetor për zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Rini në bashkëpunim me Agjencinë, institucionet publike qendrore dhe Këshillin Qendror, të cilin e shqyrton dhe aprovon Komisioni Shtetëror.

4. Strategjia zbatohet me mjete nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 18
Puna rinore

1. Puna rinore kryesisht bazohet në metodat e edukimit joformal për zhvillimin e kapaciteteve të të rinjve, organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë.

2. Profesionistët me fushëveprim në sektorin e rinisë që përmbushin kriteret specifike mund të

kualifikohen për licencë të punëtorit rinor dhe për trajnim paraprak të ofruar nga Agjencia apo nga partnerët e jashtëm të aprovuar nga Agjencia për ofrimin e trajnimeve të tilla.

3. Punëtorët rinorë do të kenë përparësi për bashkëpunim me institucionet publike qendrore dhe lokale, Këshillin Qendror dhe Këshillat Lokalë në identifikimin e çështjeve rinore.

4. Profili, përgjegjësitë, të drejtat dhe licencimi i punës rinore rregullohen me akt nënligjor nga ministria përkatëse për rini.

Neni 19
Edukimi joformal

1. Edukimi joformal realizohet në të gjitha fushat sipas nevojave dhe kërkesave të të rinjve duke përfshirë por mos u kufizuar në fushat e aktivizimit qytetar, punësimit, dialogut ndërkulturor, shëndetit dhe edukimit fizik.

2. Edukimi joformal ngre kapacitetet e të rinjve për integrim në jetën ekonomike dhe sociale publike me fokus te të rinjtë e margjinalizuar.

3. Ofrimi i edukimit joformal rregullohet me akt nënligjor nga ministria përkatëse për rini.

Neni 20
Vullnetarizmi rinor

1. Vullnetarizmi rinor rregullohet me marrëveshje ndërmjet palëve përkatëse. Ofruesit e vullnetarizmit rinor kanë për detyrë të bëjnë evidencimin e punës vullnetare.

2. Agjencia ka përgjegjësi të promovojë vullnetarizmin rinor dhe të ofrojë certifikime për punë vullnetare. Puna vullnetare e certifikuar shërben në proceset e punësimit dhe edukimit.

3. Është e ndaluar që vullnetarizmi rinor të shfrytëzohet për qëllime përfituese nga ofruesit e vullnetarizmit apo të dëmtojë shëndetin e vullnetarëve rinorë.

4. Vullnetarët rinorë nuk përfitojnë financiarisht nga puna vullnetare mirëpo ofruesit e vullnetarizmit rinor mund të mbulojnë shpenzimet e tyre gjatë kohës së angazhimit.

5. Për promovimin e punës vullnetare institucionet qendrore dhe lokale mund të ofrojnë masa stimuluese të ndryshme.

6. Vullnetarizmi rinor nuk duhet t'i kufizojë detyrat dhe obligimet lidhur me shkollimin, studimin ose arsimimin profesional të të rinjve.

7. Vullnetarizmi rinor rregullohet me akt nënligjor nga ministria përkatëse për rini.

Neni 21
Aktet normative të organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë dhe evidencimi

1. Aktet e brendshme normative të organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë duhet të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji dhe me legjislacionin në fuqi.

2. Këshilli Qendror dhe Këshillat Lokal bëjnë evidencimin e anëtarëve sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22
Financimi

1. Mjetet financiare për zbatimin e këtij ligji sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, të hyrat vetanake, sponsorizimet e donacionet dhe financimet tjera alternative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Të hyrat vetanake që krijohen nga ky ligj derdhen në buxhetin e shtetit dhe ndahen sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE SHFUQIZUESE

Neni 23
Bartja e funksioneve dhe përgjegjësive

1. Funksionet dhe përgjegjësitë e Departamentit të Rinisë në Ministri të cilat barten në strukturën e brendshme organizative të Agjencisë janë të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji.

2. Numri i vendeve të punës dhe stafi që do të kalojë nga Departamenti i Rinisë në Agjenci do të bëhet me transferim të përhershëm në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publikë.

Neni 24
Aktet nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji do të miratohen jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 25
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë së Republikës së Kosovës, dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-264
11 korrik 2024

Shpallur me dekretin Nr. DL-106/2024, datë 30.07.2024 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu